Shoqëria zbaton metodën e thjeshtuar të SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë që përdor një humbje të pritshme për të gjitha të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera. Për të matur humbjet e pritshme të kredisë, Te arkëtueshmet tragëtare dhe të arkëtueshmet e tjera janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditëve të kaluara. Normat e pritshme të humbjeve bazohen në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe kohore dhe humbjet historike përkatëse të kreditit që kanë ndodhur brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme.

Kompensimi për humbjen e pritshme të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të tjera të arkëtueshme përcaktohet sipas matricës së provigjonit, normat e humbjeve dhe HPK janë paraqitur në tabelën më poshtë. Matrica e provigjonit bazohet në numrin e ditëve që një aktiv ka kaluar, efekti i informacioneve që kërkohen me ardhje konsiderohet si i parëndësishëm.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe arkëtueshmeve të tjera (vazhdim)

Në % të vlerës bruto	Norma e humbjes	HPK përgjatë jetës së aktivitetit
Të arkëtueshme		
- Të pa maturuara	1%	(914,744)
- 1-30 ditë të vonuara	1.5%	(1,203,737)
- 31-90 ditë të vonuara	2%	(417,217)
- 91 deri në 180 ditë të vonuara	25%	(1,215,939)
- 181 deri në 270 ditë të vonuara	50%	(1,955,490)
- 271 deri në 360 ditë të vonuara	75%	(163,788)
- mbi 360 ditë vonuar	100%	(28,548,685)

Vlerësimi i modelit të biznesit. Modeli i biznesit drejton klasifikimin e aktiveve financiare. Drejtimi aplikoi gjykimin në përcaktimin e nivelit të grumbullimit dhe të portofoleve të instrumenteve financiare gjatë kryerjes së vlerësimit të modelit të biznesit. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Shoqëria konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin "të mbajtura për tu mbledhur" të biznesit. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e "të mbajtura për tu mbledhur" të biznesit, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi. Shoqëria vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes duke krahasuar vlerën e shitjeve me vlerën e portofolit që i nënshtrohet vlerësimit të modelit të biznesit mbi jetëgjatësinë mesatare të portofolit.

Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("VPPI"). Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit kërkohet gjykim. Klasifikimi në koston e amortizuar (KA) ose vlerës së drejtë nëpërmjet kategorive të tjera të të ardhurave përmbledhëse (VDNAGJ) kërkon që flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare të jenë vetëm pagesa e principalit dhe interesit. Nëse kriteri i VPPI nuk është plotësuar, p.sh. flukset e mjeteve monetare nuk përbëhen vetëm nga pagesat e principalit dhe interesit, aktivet financiare duhet të caktohen në kategorinë e FVPL-ve. Pagesat e interesit janë konsiderata për vlerën kohore të parasë, riskun e kredisë, rrezikun e likuiditetit dhe shpenzimet administrative dhe mund të përfshijë një marzh fitimi dhe, kur është e mundur, koston (rregullatore) e kapitalit. Pagesat ndaj debitorit për shkak të normave negative të interesit, në këtë mënyrë, nuk bien në kundërshtim me kriterin e VPPI. Pagesat e principalit janë ripagesat e shumës së principalit, pra vlera e drejtë në njohjen fillestare. Të gjitha kontratat që nuk plotësojnë kriterin e VPPI-së maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Në kontrast me përcaktimin e modelit të biznesit, kriteri i VPPI vlerësohet në nivel të kontratës individuale ose në bazë të një grupi kontratash homogjene.

4. Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Miratimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare". Shoqëria ka miratuar SNRF 9, Instrumentet Financiare, që nga 1 janari 2018. Shoqëria ka zgjedhur të mos rivendosë shifrat krahasuese, por të njohë çdo rregullim të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve financiare në fitimet e mbajtura të hapura, që nga data e zbatimit fillestar të standardet, 1 janar 2018. Bazuar në analizën e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë, Drejtimi i Shoqërisë nuk ka identifikuar ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e saj financiare nga adoptimi i standardit të ri më 1 janar 2018 me përjashtim të një matrice të re provigjonesh që do të aplikohet në llogaritë e arkëtueshme për të cilat për shkak të ndikimit të ulët, Shoqëria vazhdoi të përdorte të njëjtat norma të provigjoneve.

Rrjedhimisht, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentet Financiare: Shënimet shpjeguese, janë zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Dhënia e informacioneve shpjeguese për periudhën krahasuese përsërit shënimet shpjeguese të bëra në vitin paraprak. Politikat e reja të rëndësishme kontabël të zbatuara në periudhën aktuale përshkruhen në Shënimin 2. Politikat kontabël të zbatuara para 1 janarit 2018 dhe të zbatueshme për informacionin krahasues janë dokumentuar në Shënimin 30. Tabela në vijim krahason vlerat kontabël të secilës

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Miratimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (vazhdim)

klasë të aktiveve financiare si të matura më parë në përputhje me SNK 39 dhe shumat e reja të përcaktuara me miratimin e SNRF 9 më 1 janar 2018.

Të gjitha klasat e aktiveve financiare janë riklasifikuar nga kategoritë e matjeve të kredive dhe llogarive të arkëtueshme ("L & R") sipas SNK 39 deri në kategorinë e matjes sipas SNRF 9 në datën e miratimit të standardit. HPK-të për bilancet e aseteve financiare ishin të parëndësishme.

Pajtimi i provigjonit për zhvlerësim më 31 Dhjetor 2017 dhe zbritja e humbjeve nga kreditë në 1 janar 2018.

Tabela në vijim rakordon rezervën mbyllëse të periudhës së mëparshme për zhvlerësim të matur në përputhje me modelin e humbjeve të ndodhura sipas SNK 39 ndaj kompensimit të humbjes së pritshme të kredisë, të matur në përputhje me parashikimet e humbjes sipas SNRF 9 më 1 janar 2018, nuk ka ndikim të rëndësishëm në provigjon për zhvlerësim:

	Provigjon sipas SNK 39 ose SNK 37 me 31 Dhjetor 2017	Efekti		Kompensim për humbjet e pritshme të kredisë sipas SNRF 9 në 1 Janar 2018
		Riklasifikim tek VDNFH	Riklasifikim VDNAGJ	
<i>Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme</i>				
Llogaritë e arkëtueshme	(30,782,036)	-	-	(6,024,841) (36,806,877)

Më 31 Dhjetor 2017, të gjitha detyrimet financiare të Shoqërisë janë kryer me kosto të amortizuara.

Zbatimi i SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

Shoqëria ka zbatuar metodën e thjeshtuar të kalimit në SNRF 15 dhe ka zgjedhur të zbatojë lehtësitë praktike të vlefshme për metodën e thjeshtuar të kalimit. Shoqëria zbaton SNRF 15 vetëm për kontratat që nuk janë përfunduar në datën e aplikimit fillestar (1 janar 2018). Zbatimi i SNRF 15 nuk ka sjellë ndryshime në pasqyrat financiare për shkak të arsyeve të shpjeguara më poshtë:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa bazuar ne aksione" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 12 shtator 2016 dhe efektive, ne varësi te qasjes, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për njesite ekonomike që zgjedhin të aplikojnë opsionin përjashtimit te përkohshëm, ose kur njësia ekonomike aplikon per here te pare SNRF 9 për njësitet ekonomike që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet dhe paradhënia në monedhë të huaj " (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferimet e Aktivit te Investuar" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

5. Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

Disa standarde dhe interpretime të reja që janë nxjerre dhe janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ose më vonë, Shoqëria nuk i ka zbatuar në një kohe më të hershme.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësin merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qera operative ose qera financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit. Qiramarrësi do të kërkohet të njohë: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qera operative ose qera financiare dhe të kontabilizojë këto dy lloje të qirasë ndryshe.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021). SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i jep lejon të Shoqëritë për të mbajtur kontabilitetin për kontratat e sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Si pasojë, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë performancën financiare të ndërmarrjeve të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i vetëm i bazuar në parime për të llogaritur të gjitha llojet e kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit që një sigures mban. Standardi kërkon njohjen dhe matjen e Shoqërive të kontratave të sigurimit në: (i) një vlerë aktuale të rregulluar nga rreziku i flukseve monetare të ardhshme (flukset monetare të përmbushjes) që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për flukset e mjeteve monetare të përmbushjes në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e vëzhgueshëm të tregut; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson të ardhurat e pafitura në Shoqërinë e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual). Siguruesit do të njohin fitimin nga një Shoqërie e kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një Shoqërie e kontratave është ose rezulton me humbje, Shoqëria do të njohë menjëherë humbjen. Standardi i ri nuk do të ndikojë në Shoqëri.

KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi Fitimin" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNK 12 specifikon mënyrën e llogaritjes së tatimit aktual dhe të shtyrë, por jo si të reflektojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes në SNK 12 kur ka pasiguri mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Një Shoqëri ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të marrë në konsideratë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në metodën më të mirë që parashikon zgjidhjen e pasigurisë. Një Shoqëri duhet të supozojë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të shqyrtojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre kontrolleve. Nëse një Shoqëri del në konkluzionin se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e fitimit ose humbjes së tatueshme, bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore duke përdorur shumën më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që Shoqëria pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Një Shoqëri do të pasqyrojë efektin e ndryshimit të fakteve dhe rrethanave ose të informacionit të ri që ndikon në gjykimet ose vlerësimet e kërkuara nga interpretimi si një ndryshim në vlerësimin kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi ose vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose skadimi i të drejtave të autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Përmirësimet vjetore të SNRF-ve 2015-2017 - ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (i publikuar më 12 dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). SNRF 3 tregon se një blerës duhet të masi përsëri interesin e tij të mbajtur më parë në një operacion të përbashkët kur të marrë kontrollin e biznesit. Në anën tjetër, SNRF 11 tani shpjegon në mënyrë eksplicite se investitori nuk duhet të masi përsëri vlerën e interesit të mbajtur më parë kur merr kontrollin e përbashkët të një operacioni të përbashkët, e ngjashme me kërkesat ekzistuese kur një pjesëmarrës bëhet një sipërmarrje e përbashkët dhe anasjelltas. SNK 12 i ndryshuar shpjegon se një Shoqëri njih të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në rastet kur ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjenerojnë fitimet e shpërndara, përkatësisht në fitim ose humbje ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Është e qartë se kjo kërkesë zbatohet në të gjitha rrethanat përderisa pagesat për instrumentet financiare të klasifikuara si kapital janë shpërndarjet e fitimeve dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave të ndryshme tatimore për fitimet e shpërndara dhe të pashpërndara. SNK 23 i rishikuar tani përfshin udhëzime të qarta se huatë e marra në mënyrë specifike për financimin e një aktivi të specifikuar përjashtohen nga grupi i kostove të huazuara të përgjithshme të pranueshme për kapitalizim derisa aktivi specifik është i plotë. Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të saj.

Ndryshimet në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar (i publikuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020). Korniza Konceptuale e rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi matjen; udhëzime për raportimin e performancës financiare; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara - në veçanti përkufizimi i një detyrimi; dhe sqarime në fusha të rëndësishme, të tilla si rolet e administrimit, kujdesi dhe paqartësia e matjes në raportimin financiar.

Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (i publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020). Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialitetit dhe si duhet zbatuar duke përfshirë në udhëzim që deri më tani është paraqitur diku tjetër në SNRF. Përveç kësaj, shpjegimet që shoqërojnë këto janë përmirësuar. Së fundmi, ndryshimet sigurojnë që përkufizimi i materialit të jetë i qëndrueshëm në të gjitha standardet e SNRF-ve. Informacioni është material nëse heqja ose fshehja e tij mund të pritet që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme të bëjnë në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat sigurojnë informacion financiar për një njësi raportuese specifike Shoqëria aktualisht po vlerëson ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat e saj financiare. Nëse nuk është përshkruar ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

6. Përcaktimi i vlerave të drejta

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e tregut të vëzhgueshëm (dmth., inputet e pa vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë.

Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor hyrje të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një input vlerësimi vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj. Vlera e drejtë e aktiveve dhe pasiveve financiare, së bashku me vlerën kontabël neto të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar vlerësohen vetëm për qëllime shpjeguese dhe janë si më poshtë:

	Vlera e drejtë	
31 dhjetor 2018	Vlera Kontabël	Niveli 3
Llogari të arkëtueshme	67,414,699	67,414,699
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	28,455,685	28,455,685
	95,870,384	95,870,384
Huatë	(257,150,640)	(257,150,640)
	(257,150,640)	(257,150,640)

	Vlera e drejtë	
31 dhjetor 2017	Vlera Kontabël	Niveli 3
Llogari të arkëtueshme	69,152,428	69,152,428
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	51,372,970	51,372,970
	120,525,398	120,525,398
Huatë	(448,322,676)	(448,322,676)
	(448,322,676)	(448,322,676)

Vlera e drejtë në nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë është vlerësuar duke përdorur teknikën e vlerësimit të flukseve monetare të skontuara. Vlera e drejtë e instrumenteve me normë të luhatshme që nuk janë kuotuar në një treg aktiv është vlerësuar të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël. Vlera e drejtë e instrumenteve me normë fikse të interesit të pavlerësuar u vlerësua bazuar në flukset monetare të ardhshme të parashikuara që priten të skontohen me normat aktuale të interesit për instrumente të reja me rreziqe të ngjashme kredie dhe maturime të mbetura.

Aktivët financiarë të mbajtura me koston e amortizuar. Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme përfaqëson vlerën bartëse për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Detyrimet e mbartura me koston e amortizuar. Vlera e drejtë e huamarrjeve përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Vlera e drejtë e vlerësuar vlerësohet në bazë të flukseve të pritshme të mjeteve monetare të skontuara me normat aktuale të interesit për instrumente të reja me rreziqe të ngjashme kredie dhe maturime të mbetura.

Vlera e drejtë e huave është përafërsisht e barabartë me vlerën e tyre bartëse për faktin se huamarrjet mbartin norma interesi të ndryshueshme, të cilat ndryshojnë çdo muaj dhe pasqyrojnë ndryshimet në kushtet e tregut.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria ka ekspozim ndaj rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut nga përdorimi i instrumenteve financiare. Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e rrezikut. Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme sasiore përfshihen në këto pasqyra financiare.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë krijohen për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e përshtatshme të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht nga Drejtimi për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë.

Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj të trajnimit dhe menaxhimit, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Instrumentet kryesore financiare të Shoqërisë përbëhen nga arka dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huazimet dhe detyrimet e tjera aktuale.

(i) Rreziku kreditor

	Shënim	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Llogari të arkëtueshme	10	67,414,699	69,152,428
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	12	28,455,685	51,048,941
		95,870,384	120,201,369

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Nuk ka përqendrim gjeografik të riskut të kredisë. Drejtimi i Shoqërisë shqyrton analizën e maturimit së llogarive të arkëtueshme dhe analizon balancat e vonuara. Prandaj, Drejtimi e konsideron të përshtatshme të sigurojë informacionet e maturimit dhe të tjera rreth riskut të kredisë siç detajohen më poshtë. Shoqëria beson se shumata e paplotësuara që janë të kaluara janë ende të mbledhshme, bazuar në sjelljen historike të pagesave dhe maturimin e riskut të kredisë së klientit.

Maturimi i llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 ishte si vijon:

	31 Dhjetor 2018		
	Të arkëtueshmet bruto	Kompensim për zhvlerësim	Të arkëtueshmet neto
Të pa maturuara	28,111,793	(914,744)	27,197,049
1-30 ditë	30,743,553	(1,203,737)	29,539,817
31-90 ditë	8,759,054	(417,217)	8,341,838
91-180 ditë	3,890,632	(1,215,939)	2,674,692
181-270 ditë	3,503,465	(1,955,490)	1,547,975
271-360 ditë	206,998	(163,788)	43,210
> 360 ditë	26,618,803	(28,548,685)	(1,929,882)
Total	101,834,298	(34,419,600)	67,414,699

Bazuar në politikën kontabël të Shoqërisë, llogaritë e arkëtueshme të papaguara për më shumë se 360 ditë janë zhvlerësuar në total me 102%, ku 100% përfaqëson zhvlerësimin e bilancit total të arkëtueshmeve dhe 2% shtesë përfaqëson rrezikun e vendit, pasi Shoqëria ka shpenzime ligjore në mbledhjen e të arkëtueshmeve problematike. Shoqëria ka llogaritur kompensimet për zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme tregtare për periudhën aktuale bazuar në kërkesat e SNRF 9 (2017: SNK 39). Efekti i tranzicionit njihet në fitimet e pasqyrës duke filluar prej 1 janari 2018.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënime shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Rreziku kreditor (vazhdim)

Maturimi i llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 ishte si vijon:

	31 dhjetor 2017		
	Të arkëtueshmet bruto	Kompensim për zhvlerësim	Të arkëtueshmet neto
Të pa maturuara	266,304	(7,989)	258,315
1-30 ditë	42,726,502	(1,495,428)	41,231,074
31-90 ditë	15,135,664	(605,427)	14,530,237
91-180 ditë	7,151,921	(1,931,019)	5,220,902
181-270 ditë	4,795,518	(2,493,669)	2,301,849
271-360 ditë	729,522	(561,732)	167,790
> 360 ditë	29,129,032	(29,711,613)	(582,581)
Zbatimi i SNRF 9	-	-	6,024,841
Total	99,934,463	(36,806,876)	69,152,428

(ii) Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që një Shoqëri do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj thirrjeve të përditshme në burimet e disponueshme të saj në para. Shoqëria monitoron riskun e likuiditetit në baza periodike me qëllim që të menaxhojë detyrimet e veta kur ato duhet të përmbushen. Shoqëria synon të mbajë një bazë të qëndrueshme financimi që kryesisht konsiston në huamarjen, tregtinë dhe detyrimet e tjera.

	Shënime	31 dhjetor 2018				Totali
		Deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vites	Mbi 5 vite	
Llogari të arkëtueshme	10	67,414,699	-	-	-	67,414,699
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	12	28,455,685	-	-	-	28,455,685
		95,870,384	-	-	-	95,870,384
Huatë	14	(257,150,640)	-	-	-	(257,150,640)
Llogari të pagueshme	16	(186,858,208)	-	-	-	(186,858,208)
Shpenzime të përlllogaritura	17	(35,097,391)	-	-	-	(35,097,391)
		(479,106,239)	-	-	-	(479,106,239)
Hendeku i likuiditetit		(383,235,855)	-	-	-	(383,235,855)

	Shënime	31 Dhjetor 2017				Totali
		Deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Mbi 5 vite	
Llogari të arkëtueshme	10	69,152,428	-	-	-	69,152,428
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	12	51,372,970	-	-	-	51,372,970
		120,525,398	-	-	-	120,525,398
Huatë	14	(448,322,676)	-	-	-	(448,322,676)
Llogari të pagueshme	16	(144,406,955)	-	-	-	(144,406,955)
Shpenzime të përlllogaritura	17	(28,149,544)	-	-	-	(28,149,544)
		(620,879,175)	-	-	-	(620,879,175)
Hendeku i likuiditetit		(500,353,777)	-	-	-	(500,353,777)

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Edhe pse hendeku i likuiditetit është negativ për të dyja periudhat e mbyllura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017, Drejtimi i Shoqërisë nuk e konsideron këtë si rrezik të likuiditetit, duke qenë se huamarrjet lidhen me Porsche Corporate Finance GmbH dhe shumica e llogarive të pagueshme lidhen me fabrikat e Porsche Group, të cilat janë palë të lidhura të Shoqërisë (shënimi 26).

(iii) Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit të rrjedhës së parasë është rreziku që flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Risku i normës së interesit të vlerës së drejtë është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Shoqëria përballet me rrezikun e fluksit të mjeteve monetare të normës së interesit në lidhje me linjën e saj të kredisë të marrë nga Porsche Corporate Finance GmbH, e cila është me një normë të ndryshueshme. Drejtiminuk ka hyrë në ndonjë derivativ për të mbrojtur këtë rrezik.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Një ndryshim prej 100 pikësh bazë në normat e interesit më 31 Dhjetor 2018 do të kishte rritur ose ulur kapitalin dhe fitimin ose humbjen për 3,876 mijë Lekë (2017: 5,045 mijë Lekë). Foreign exchange risk

Shoqëria kryen transaksione në lekë dhe në euro. Rreziku i valutës menaxhohet nëpërmjet përdorimit të parimeve të përputhshmërisë së aktiveve / pasiveve me shumicën e aktiveve dhe pasiveve financiare të shprehura në Euro, me ekspozimin neto Lek që nuk është i rëndësishëm. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë këmbim të ardhshëm ose transaksionet e derivateve të ngulitura më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017.

Ekspozimi ndaj riskut të monedhës së huaj

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të monedhës së huaj më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 ishte si më poshtë:

31 Dhjetor 2018		
	EUR (konvertuar në LEK)	LEK
Llogari të arkëtueshme	33,710,478	33,704,221
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	19,225,491	9,230,194
	52,935,969	42,934,415
Huatë	(257,150,640)	-
Llogari të pagueshme	(183,351,292)	(3,506,917)
Shpenzime të përlllogaritura	-	(35,097,391)
	(440,501,932)	(38,604,308)
Hendeku i monedhës në 31 Dhjetor 2018	(387,565,963)	4,330,107

31 December 2017		
	EUR (konvertuara në LEK)	LEK
Llogari të arkëtueshme	33,537,645	35,614,783
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	41,894,741	9,478,229
	75,432,386	45,093,012
Huatë	(448,322,676)	-
Llogari të pagueshme	(140,732,543)	(3,674,412)
Shpenzime të përlllogaritura	-	(28,149,544)
	(589,055,219)	(31,823,956)
Hendeku i monedhës në 31 Dhjetor 2017	(513,622,833)	13,269,056

Më 31 dhjetor 2018, 1 euro ishte ekuivalente me 123.42 lekë (2017: 132.95 lekë).

Përforcimi ose dobësimi i lekut me 10% kundrejt euros në 31 Dhjetor 2018 do të kishte rritur ose ulur kapitalin dhe fitimin ose humbjen për 38,757 mijë Lekë (2017: 51,362 mijë Lekë).

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

(iii) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë gjatë menaxhimit të kapitalit janë të mbrojnë aftësinë e Shoqërisë për të ndjekur parimin e vijnësisë për të siguruar kthimin e aksionarëve dhe përfitimet për palët e tjera të interesit dhe për të ruajtur një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit. Kapitali përbëhet nga kapitali i përgjithshëm. Shoqëria nuk është institucion financiar dhe nuk i nënshtrohet kërkesave të kapitalit të imponuara nga jashtë.

7. Aktive afatgjata jo-materiale

Aktive afatgjata jo-materiale janë të detajuara si më poshtë:

	Të drejtat e shpërndarjes	Programi Kompjuterik i blerë	Total
Shpenzime			
1 janar 2017	172,550,000	6,170,858	178,720,858
Shtesa	-	-	-
Pakësime	-	(87,576)	(87,576)
Bilanci në 31 dhjetor 2017	172,550,000	6,083,282	178,633,282
1 janar 2018	172,550,000	6,083,282	178,633,282
Shtesa	-	1,008,369	1,008,369
Pakësime	-	-	-
Bilanci në 31 dhjetor 2018	172,550,000	7,091,651	179,641,651
Amortizimi i akumuluar			
1 january 2017	(109,998,980)	(5,891,390)	(115,890,370)
Amortizimi për vitin	(25,883,181)	(161,572)	(26,044,753)
Pakësime	-	87,576	87,576
Bilanci në 31 dhjetor 2017	(135,882,160)	(5,965,386)	(141,847,546)
1 january 2018	(135,882,160)	(5,965,386)	(141,847,546)
Amortizimi për vitin	(25,882,500)	(98,371)	(25,980,870)
Pakësime	-	-	-
Bilanci në 31 dhjetor 2018	(161,764,660)	(6,063,756)	(167,828,416)
Vlera neto e librave			
31 Dhjetor 2017	36,667,840	117,896	36,785,735
31 dhjetor 2018	10,785,340	1,027,894	11,813,234

Gjatë vitit 2012, Shoqëria hyri në një marrëveshje për të drejtat e shpërndarjes me Classic sh.p.k. për të blerë të drejtat ekskluzive për të importuar automjete Volkswagen për pasagjerë prej Volkswagen AG, për një shumë prej 172,550 mijë Lekë ekuivalente me 1,250 mijë Euro.

Asnjë aktiv afatgjatë jo material nuk i është vendosur ndaj palëve të treta si kolateral në lidhje me huamarrjet në 31 dhjetor 2018 (2017: asnjë).

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale

Lëvizjet në aktivet afatgjata materiale në 31 dhjetor 2018 jepen si vijon:

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Pajisje elektronike	Mobilje dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Totali
1 janar 2018	521,616,844	119,531,938	80,705,142	18,607,550	45,400,727	4,276,806	790,139,007
Shtesa	-	-	-	953,452	4,643,488	1,697,980	7,294,920
Pakësime	-	-	-	-	(64,066)	-	(64,066)
Transferime në inventar	-	-	-	-	-	(1,330,631)	(1,330,631)
Teprica më 31 dhjetor 2018	521,616,844	119,531,938	80,705,142	19,561,001	49,980,149	4,644,154	796,039,229
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>							
1 janar 2018	-	(40,006,567)	(60,382,370)	(16,539,812)	(28,636,787)	(1,056,572)	(146,622,107)
Shpenzimi i vitit	-	(3,288,496)	(2,688,104)	(1,679,981)	(13,540,585)	(863,799)	(22,060,966)
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	64,066	-	64,066
Transferime në inventar	-	-	-	-	-	1,042,328	1,042,328
Teprica më 31 dhjetor 2018	-	(43,295,063)	(63,070,474)	(18,219,793)	(42,113,306)	(878,043)	(167,576,679)
<i>Vlera kontabël neto</i>							
1 janar 2018	521,616,844	79,525,371	20,322,773	2,067,738	16,763,941	3,220,234	643,516,900
31 dhjetor 2018	521,616,844	76,236,875	17,634,668	1,341,208	7,866,843	3,766,112	628,462,550

Automjetet e rikthyera Shoqërisë në fund të kontratave të qirasë operative u transferuan në inventar. (Shënimi 9).

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk i është vendosur palëve të treta si kolateral në lidhje me huamarrjet në 31 dhjetor 2018 (2017: asnjë).

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Lëvizjet në aktivet afatgjata materiale në 31 dhjetor 2017 jepen si vijon:

Kosto	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Pajisje elektronike	Mobilje dhe pajisje zyre	Mjete transporti	Totali
1 janar 2017	521,616,844	119,531,938	79,080,848	19,188,113	42,803,275	4,399,008	786,620,025
Shtesa	-	-	1,776,406	492,596	2,648,785	2,946,175	7,863,963
Pakësime	-	-	(152,112)	(1,073,159)	(51,333)	(3,068,37)	(4,344,981)
Transferime në inventar	-	-	-	-	-	-	-
Teprica më 31 dhjetor 2017	521,616,844	119,531,938	80,705,142	18,607,550	45,400,727	4,276,806	790,139,007
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>							
1 janar 2017	-	(31,999,565)	(53,609,548)	(14,767,318)	(22,621,374)	(1,614,790)	(124,612,595)
Shpenzimi i vitit	-	(8,007,001)	(6,842,789)	(2,845,653)	(6,066,746)	(1,027,110)	(24,789,300)
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	69,968	1,073,159	51,333	1,585,328	2,779,787
Transferime në inventar	-	-	-	-	-	-	-
Teprica më 31 dhjetor 2017	-	(40,006,567)	(60,382,370)	(16,539,812)	(28,636,787)	(1,056,572)	(146,622,108)
<i>Vlera kontabël neto</i>							
1 janar 2017	521,616,844	87,532,372	25,471,300	4,420,795	20,181,901	2,784,218	662,007,430
31 dhjetor 2017	521,616,844	79,525,371	20,322,773	2,067,738	16,763,941	3,220,234	643,516,899

Automjetet e rikthyera Shoqërisë në fund të kontratave të qirasë operative u transferuan në inventar. (Shënimi 9).

Asnjë aktiv afatgjatë material nuk i është vendosur palëve të treta si kolateral në lidhje me huamarrjet në 31 dhjetor 2017 (2016: asnjë).

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

9. Inventarë

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Automjete	486,177,762	511,662,180
Automjete në tranzit	123,850,183	111,210,264
Pjesë këmbimi	24,160,862	27,866,194
Të tjera	7,900,185	5,951,154
Cregjistrimi i inventarit	(25,533,594)	(21,980,614)
	616,555,399	634,709,179

Asnjë inventar nuk i është vendosur palëve të treta si kolateral në lidhje me huamarrjet në 31 dhjetor 2018, (2017: asnjë)

Kosto e inventarit e njohur si shpenzim i periudhës përfaqëson koston e shitjeve në vlerën 7,716 mijë Lekë, (2017: 3,255 mijë Lekë).

Inventarët me vlerën 616,555 mijë (2017: 634,709 mijë Lekë) vlerësohen me më të ultën mes koston dhe vlerës neto të realizueshme në 31 dhjetor 2018. Lëvizjet në cregjistrimin e inventarit janë si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 janar	(21,980,615)	(22,531,436)
Shpenzimi për vitin	(7,716,478)	(3,255,347)
Rimarrje e provizionit	4,163,500	3,806,168
Humbja neto nga cregjistrimi	(3,552,979)	550,821
31 dhjetor	(25,533,594)	(21,980,615)

Gjatë 2018, Shoqëria rimorri 4,163 mijë Lekë (2017: 3,806 mijë Lekë) prej një cregjistrimi të mëparshëm të inventarit. Shoqëria ka shitur të gjitha mallrat që më parë ishin zhvlerësuar afërsisht në vlerën e tyre kontabël neto. Vlera është përfshirë në koston e shitjes dhe më pas në fitimin apo humbjen e vitit.

10. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të drejta nga palë të treta	59,073,708	45,158,113
Të drejta nga palë të lidhura (shënimi 26)	8,340,991	23,994,315
	67,414,699	69,152,428

Detajet mbi maturimin e llogarive të arkëtueshme janë dhënë në shënimet shpjeguese 6.

Lëvizjet në provizionin për zhvlerësim për llogaritë e arkëtueshme janë si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 janar	(30,782,036)	(29,525,600)
Zbatimi i SNRF 9	(6,024,841)	-
Çrregjistrime	(9,943,861)	(9,073,742)
Rimarrje e provigjionit	12,331,138	7,817,306
Shpenzimi i vitit	2,387,277	1,256,436
31 dhjetor	(34,419,600)	(30,782,036)

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

11. Aktive të tjera

Aktive të tjera janë të detajuara si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzime të shtyra	8,826,467	7,952,013
TVSH e kreditueshme	-	21,606,221
Të tjera	3,702	4,497,343
	8,830,169	34,055,577

Në shpenzimet e shtyra përfshihet vlera prej 4,189 mijë Lekë (2017: 4,189 mijë Lekë) e parapaguar për marrjen me qira të ambjenteve të reja për qëllime biznesi dhe administrate, e pritshme për të nisur operimin nga marsi 2015.

Në 2017, pjesë e llogarive të tjera është shuma 4,000 mijë Lekë e depozituar në bankë dhe vendosur si kolateral për garanci bankare për certifikimin si Operator Ekonomik i Autorizuar nga Drejtoria e Doganave. Në 2018, depozita për garancinë është liruar dhe garancia bankare ka si kolateral linjë kredie (shih Shënimin 27).

12. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre janë detajuar si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në arkë	105,956	324,030
Mjete monetare në bankë	28,349,730	51,048,941
	28,455,685	51,372,970

13. Kapitali aksionar

Shoqëria zotërohet 100 % nga Porsche Holding GmbH, e cila është Shoqëria mëmë.

Pala kontrolluese përfundimtare e Shoqërisë është Volkswagen AG. Kapitali aksionar i regjistruar është 707,911,000 Lekë i ndarë në 707,911 aksione me vlerë nominale prej 1000 Lekë secili (2017: 707,911,000 Lekë i ndarë në 707,911 aksione me vlerë nominale prej 1000 Lekë secili).

14. Huamarrjet

E përfshirë në huamarrje është linja e kreditit me një kufi maksimal prej 6,000 mijë Euro me datë maturimi të pacaktuar dhe normë interesi Euribor 1m +2.05% (2017: 1m+2.05%), e huazuar nga Porsche Corporate Finance GmbH. Marrëveshja shqyrtohet në baza vjetore në varësi të nevojave për likuiditet.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

15. Provigjione

Provizionet janë të detajuara si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Garanci të zgjatura	9,249,870	9,281,327
Shërbime ligjore dhe konsulencë	-	1,802,250
Të tjera	23,216,969	23,292,516
	32,466,839	34,376,093

Garanci të zgjatura janë diferencat e akumuluar me fabrikat, si pasojë e riparimeve brenda garancisë të kryera për klientët e Shoqërisë. Teprica në 31 dhjetor 2018 pritet të jetë ose e shfrytëzuar plotësisht ose të rimerret deri në fund të vitit 2019. Provizione të tjera përfshijnë kosto që pritet të ndodhin për Shoqërinë në të ardhmen, si pasojë e ndryshimeve teknologjike të tregut në industrinë ku Shoqëria ushtron aktivitetin e saj.

16. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë detajuar si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Ndaj palëve të treta	136,831,622	81,368,497
Ndaj palëve të lidhura (shënimi 26)	50,026,586	63,038,458
	186,858,208	144,406,955

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura janë kryesisht nga blerja e inventarëve nga fabrikat pjesë e grupit.

17. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera janë detajuar si vijon:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagime nga klientët	17,056,663	27,226,462
Shpenzime të përlllogaritura	35,097,391	28,149,544
TVSH e pagueshme neto	16,345,609	-
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	1,916,128	1,876,943
Të tjera tatime të pagueshme	2,480,939	2,255,169
	72,896,730	59,508,117

Parapagimet nga klientët përfshijnë tarifën e rezervimit të paguar nga klienti mbi importin e automjeteve nga prodhuesi.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

18. Të Ardhurat nga shitjet

Të ardhurat nga shitjet janë të detajuara si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Automjete	2,220,759,042	2,021,798,894
Pjesë këmbimi	327,281,750	332,844,230
Shërbime	61,968,902	64,785,471
Qira operative	574,235	461,570
Të tjera	8,303,951	1,555,909
	2,618,887,879	2,421,446,074

19. Kosto e mallrave të shitur

Kosto e mallrave të shitur përbëhet si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Automjete	1,975,845,951	1,798,455,608
Pjesë këmbimi dhe të tjera	183,586,670	181,100,665
Cregjistrimi i inventarit në vlerën neto të realizueshme	7,716,478	(550,821)
	2,167,149,099	1,979,005,452

20. Personeli

Shpenzimet për personelin janë të detajuara si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Paga	83,159,552	79,182,927
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	12,843,936	12,333,685
Bonuse	55,060,544	47,586,916
Shpenzime të tjera personeli	5,747,858	5,883,644
	156,811,891	144,987,172

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

21. Furnizime dhe shërbime

Furnizime dhe shërbime janë detajuara si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Riparime dhe mirëmbajtje	38,744,025	40,598,069
Reklama	28,014,328	29,625,605
Qira	25,740,128	25,938,619
Energji elektrike, karburant dhe ujë	12,102,386	12,496,031
Tarifat ligjore dhe për konsulencë	11,412,446	10,529,060
Akomodimi dhe udhëtimi	7,957,103	7,477,111
Sigurim	5,497,583	5,808,935
Telekomunikim	3,985,635	7,289,499
Regjistrim i automjeteve	3,405,555	3,212,207
Transport	2,655,316	549,532
Shpenzime garancie	2,278,252	48,329
Aktive me vlerë të ulët	1,979,103	1,852,453
Shpenzime përfaqësimi	1,891,230	2,821,275
Pajisje zyre	1,160,328	1,418,284
Sponsorizime	956,759	1,703,096
Të ndryshme	349,973	1,422,903
	148,130,150	152,791,008

22. Shpenzime të tjera neto

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	3,741,207	(1,256,436)
Të tjera provigjone	(5,580,240)	(1,272,441)
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	423,879
Të ardhura të tjera	652,205	943,883
Shpenzime të tjera	(4,773,522)	(7,961,617)
	(5,960,349)	(9,122,732)

Shpenzime të tjera neto përfshin tarifat vjetore dhe taksat për bashkinë, regjistrimin e makinave të Shoqërisë, pagesa shtesë për pjesët e kthyeshme, etj.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

23. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë të detajuara si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Komisionet bankare	(2,075,602)	(2,150,695)
Shpenzime interesi	(7,103,728)	(5,530,504)
Shpenzime financiare	(9,179,330)	(7,681,199)
Të ardhura nga interesi	2,142	-
Fitim neto nga kursi i këmbimit	42,011,886	9,276,644
Të ardhura të tjera financiare neto	402,037	328,245
Të ardhura financiare	42,416,066	9,604,888
	33,236,736	1,923,689

Fitimet nga kurset e këmbimit janë ndikuar kryesisht nga luhatjet e mëdha në monedhën e Euro-s gjatë vitit, për shkak të blerjeve të mallrave për rishitje nga palët e lidhura në këtë monedhë.

24. Tatim fitimi

Tatim fitimi i njohur përbëhet si vijon:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Tatim fitimi aktual	24,565,016	18,689,783
	24,565,016	18,689,783

Tatimi i fitimit në Shqipëri vlerësohet në normën 15 % të fitimit të tatueshëm (2017: 15%).

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

Tatim fitimi (vazhdim)

Në vijim paraqitet rakordimi ndërmjet tatim fitimit të llogaritur dhe shpenzimit të tatim fitimit:

		2018		2017
Fitimi para tatimit		126,031,289		86,629,343
Përqindja e tatimit	15%	18,904,693	15%	12,994,401
Shpenzime jo të zbritshme	4%	5,660,323	7%	5,695,382
Shpenzim i tatim fitimit	19%	24,565,016	22%	18,689,783
Tatim fitimi i paguar gjatë vitit		(20,509,368)		(16,312,633)
Tatim fitimi i parapaguar në fund të vitit		4,055,648		2,377,150

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rivlerësohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatim fitimit të cilat janë të përcaktuara nga menaxhimi si më të mundura që të rezultojnë në tatime të tjera, nëse këto pozicione do të sfidoheshin nga autoritetet tatimore.

Vlerësimi bazohet në interpretimin e legjislacionit tatimor që është miratuar ose pritet të miratohet në fund të periudhës së raportimit, dhe vendimeve të tjera të çdo gjykate të njohur për çështje të tilla. Detyrimet për gjoba, interesa dhe tatime përveçse mbi të ardhurat njihen mbi bazën e vlerësimit më të mirë nga menaxhimi, të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin në fund të periudhës raportuese.

Diferencat midis SNRF-ve dhe rregullave tatimore ligjore në Shqipëri krijojnë diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale, për qëllime të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Efekti tatimor i lëvizjeve në këto diferenca të përkohshme të zbritshme vlerësohet të jetë i parëndësishëm.

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

25. Çështjet gjyqësore

Gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, pretendime ndaj Shoqërisë mund të ngrihen. Në bazë të vlerësimeve të kryera vetë dhe duke u mbështetur mbi këshillat e brendshme profesionale, menaxhimi është i mendimit se asnjë humbje e rëndësishme nuk do të ndodhë në lidhje me këto pretendime dhe për këtë arsye asnjë provizion nuk është njohur në këto pasqyra financiare.

26. Palët e lidhura

Palët përgjithësisht konsiderohen të lidhura nëse ato janë nën një kontroll të përbashkët, ose njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë ndikim të rëndësishëm ndaj palës tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative. Duke marrë në konsideratë çdo marrëdhënie me secilën palë të lidhur, vëmendja i drejtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Më poshtë jepen palët e lidhura të Shoqërisë dhe marrëdhënia e tyre respektive në 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Porsche Hungaria (nën kontroll të përbashkët)	247,893	81,936
Porsche Leasing Sh.p.k (nën kontroll të përbashkët)	987,303	18,074,425
Porsche Mobility Sh.p.k (nën kontroll të përbashkët)	5,625,182	30,763
Volkswagen AG (pala kontrolluese përfundimtare)	1,480,613	5,807,192
Total	8,340,991	23,994,315

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura

Porsche Hungaria (nën kontroll të përbashkët)	36,408,051	15,712,605
Porsche Konstruktionen GmbH (nën kontroll të përbashkët)	429,131	635,700
Porsche Informatik GmbH (nën kontroll të përbashkët)	1,122,925	3,406,358
Porsche SCG doo (nën kontroll të përbashkët)	-	47,862
Porsche Holding GmbH (pala kontrolluese direkte)	-	218,830
Volkswagen AG (pala kontrolluese përfundimtare)	12,066,480	43,017,103
Total	50,026,586	63,038,456

Huamarrjet nga palët e lidhura

Porsche Corporate Finance GmbH (nën kontroll të përbashkët)	257,150,640	406,043,249
Total	257,150,640	406,043,249

Shpërblimet e menaxhimit

Paga	10,140,270	11,248,089
Bonuse gjatë vitit	7,741,139	5,983,898
Total	17,881,409	17,231,987

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

26. Palët e lidhura (vazhdim)

<i>Të ardhura nga palët e lidhura</i>	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Porsche Hungaria (pjesë këmbimi të riciklueshme)	244,287	333,481
Porsche Leasing Sh.p.k (shitje të automjeteve)	762,851,043	606,363,650
Porsche Leasing Sh.p.k (shërbime)	6,283,529	4,927,978
Porsche Mobility Sh.p.k (shitje të automjeteve)	62,215,785	118,944,535
Porsche Mobility Sh.p.k (shërbime)	6,937,284	6,299,572
Volkswagen AG (garancitë)	10,504,127	8,297,264
Total	849,036,054	745,166,479

<i>Blerjet nga palët e lidhura</i>	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Porsche Hungaria	353,420,243	401,824,459
Porsche Hungaria KFT (Pjesë këmbimi)	151,338,317	159,825,730
Porsche SCG	10,586,466	-
Porsche Leasing sh.p.k	25,098,885	7,491,521
Porsche Mobility sh.p.k	1,025,187	47,927,797
Volkswagen AG	1,044,132,647	802,090,486
Total	1,585,601,745	1,419,159,993

Shërbimet IT nga palët e lidhura

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Porsche Informatik	12,426,329	12,617,456
Total	12,426,329	12,617,456

<i>Shërbime nga palët e lidhura</i>	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Porsche Konstruktionen GmbH	9,564,938	6,331,282
Porsche Austria GmbH	178,326	158,976
Porsche Hungaria	-	463,722
Porsche Holding GmbH	220,422	466,854
Volkswagen AG	577,011	731,900
	10,540,697	8,152,734

Shpenzimet e interesit me palët e lidhura

Porsche Corporate Finance GmbH (Shënimi 14)	7,103,728	5,530,504
	7,103,728	5,530,504

Porsche Albania Sh.p.k.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është përcaktuar ndryshe)

27. Ngjarje të kushtëzuara dhe angazhime

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Garanci bankare për Magayinë Doganore	40,000,000	40,000,000
Garanci bankare për Zhdoganimin e Lirë	4,000,000	4,000,000
	44,000,000	44,000,000

Shoqëria ka 2(dy) garanci bankare, pranë Raiffeisen Bank Albania, të siguruar me një linjë kredie deri më 21 Maj 2019 në favor të Zyrës Qëndrore të Doganave për një vlerë prej 44,000 mijë Lekë (2017: 40,000 mijë Lekë) me një interes të barabartë me 1.5% p.a. Linja e kredisë është e siguruar përmes një letre konforti të lëshuar nga Porsche Holding GmbH në vlerën prej 400,000 Euro (ekuivalente me 53,376 mijë Lekë). Gjatë 2018 nuk ndodhi asnjë ekzekutim i garancisë (2017: asnjë).

28. Ngjarjet pas periudhës raportuese

Nuk ka asnjë ngjarje mbas datës raportuese që do të kërkonte rregullime të tjera ose informacione shtesë për këto pasqyra financiare.